

NEXHAT AGOLLI

## TË NJOHIM VALLET TONA POPULLORE

## "DY VALLE DIBRANE"

Dibra, përsa i takon krijimtarisë folklorike, paraqitet një nga rrethet më të pasura e më të larmishme. Krahas gjinive të tjera, një anë të veçantë e shumë të rëndësishme të kësaj krijimtarie e përbëjnë edhe vallet popullore. Dibranët janë mjeshtër të kërcimit, sepse ata i dashurojnë vallet që i kanë trashëguar brez pas brezi nga kohët më të hershme. Por vallja nuk është konsideruar vetëm si një element gëzimi e kënaqësie, por para së gjithash një mjet artistik, nëpërmjet të cilit ata shprehin, ndonëse në mënyrë simbolike, karakterin burrëror, trim e të fortë të dibranit. Një frymë epike i përshkon tej e ndanë këto valle. Ato janë sa të gjalla e të forta, aq dhe tërheqëse për figurat dhe lëvizjet tepër karakteristike. Forca shprehëse e tyre të bën për vete, të pushton.

Duke patur parasysh krijimtarinë koreografike ne dallojmë dy tipe, ose lloje të ndryshme kërcimi: nga njëra anë kërcimet e grave, kurse nga ana tjetër kërcimet e burrave. Këto kërcime dallohen ndërmjet tyre. Ndryshimet që shfaqen në përmbajtjen, në stilin, në karakterin si dhe në elementet plastike, ritmike, padyshim janë kushtëzuar nga faktorë historiko-shoqërorë, nga ambjenti gjeografik, klima, veshja etj.; këtu duhet të kemi parasysh edhe traditat të formuara prej kohësh.

Vallet e grave paraqiten të thjeshta si në strukturë ashtu dhe në përmbajtjen plastiko-ritmike të tyre. Kjo, në radhë të parë, është rezultat i gjendjes shoqërore të mjeruar të gruas në të kaluarën; ajo s'kish të drejta të barabarta me burrin, ishte e mënjanuar nga jeta shoqërore, e shtypur. Gruaja konsiderohej nga kanuni, zakoni dhe feja, si qenje për të punuar dhe për të rritur fëmijë. Pjesën më të madhe të jetës ajo e kalonte brenda shtëpisë dhe rrallë rastiste që të dilte përtej fshatit e jo më larg rrethit.

Dasma ishte ceremoniali më i afërt e më i dashur për gruan e për vajzën e re. Ajo gjente aty rastin për të shfaqur mendimet dhe ndjenjat e saj përmes zakoneve, këngëve dhe valleve që s'e lodhnin për asnjë çast. Dhe këto këngë, këto valle këndoheshin e hidheshin në dhomat e mbyllura, ose në oborret përpara shtëpive, sidomos nga të rejat. Pra, edhe vendi, mënyra e veshjes, në një farë mase, kanë ndikuar në karakterin e këtij lloj vallëzimi.

Vallet e grave deri vonë janë shoqëruar vetëm me këngë të karakterit lirik të dasmës. Tani ato shoqërohen edhe me çifteli, bile edhe me vegla popullore si surlja, lodra etj. Kjo lidhet drejtpërsëdrejti me ndryshimet e mëdha që po ndodhin sot në jetën e gruas, me pjesëmarrjen e saj bashkërisht me burrin si në jetën shoqërore e në punë, ashtu edhe në argëtime e valle, duke krijuar kështu kërcime të përbashkëta. Luhen nga dy, tre, ose katër valltare të shkëputura njëra nga tjetra. Dorën e majtë e vendosin në bel, kurse me të djathtë, gjysëm të ngritur, lëvizin sha-

minë; herë-herë shaminë e mbajnë me të dy duart. Hapat zhvendosen në drejtime të ndryshme: një hap i gjatë me të djathtë, dy të shkurtër me të majtën dhe me të djathtë. Kjo lëvizje i përket kërcimit që shoqërohet me çifteli. Muzika që i shoqëron këto valle është e thjeshtë, melodioze dhe ekzekutohet me një ritëm horizontal nga fillimi gjer në fund. Ndaj këto valle quhen «të rrafshta», por edhe «vençe», ose valle «grash».

Vallet e burrave, siç e theksuam më lart, paraqesin një përmbajtje plastiko-ritmike tjetër, për rrjedhim dhe një stil të veçantë. Në përgjithësi edhe repertori është më i pasur. Ja disa nga këto valle që luhen në gjithë rrethin: vallja e Randë, e Thuprës, Çamçe, Bulqizakja, e Radomirës, e Çapkonit, e Zerqanit, e Plakut, vallja e Shpejtë e Zall-Dardhës, vallet e Lehta etj.

Në përgjithësi vallet e burrave janë valle «çift» ose «dyshe». Quhen kështu, sepse në ekzekutimin e tyre marrin pjesë dy valltarë, nga të cilët kërcen vetëm i pari (në të gjithë vallen, ose vetëm në kthesën e saj), ndërsa i dyti e mban, e shoqëron me kërcim të lehtë dhe anasjelltas. Ka edhe valle të tjera (si ajo e Zall-Dardhës, disa nga vallet e Lehta, etj.), në të cilat marrin pjesë katër valltarë e lart.

Tipar dallues i valleve «çift» ose «dyshe» është ndërtimi një ose dy pjesësh, në përgjithësi me një rritje «kreshento», që nis me lëvizje të qeta, të ngadalta, të cilat në mënyrë të rrjedhshme shndërrohen në lëvizje të gjera, të gjalla, dinamike, të shpejta, ndonjëherë deri në ekzaltim (kjo në rastin e ndonjë valltari mjeshër e me individualitet të veçantë, i cili dhe improvizon). Pra, mund të themi se me gjithë karakterin disi individual dhe larminë ritmike, mbi të cilin janë ndërtuar motivet koreografike të valleve të kësaj krahine, prapëseprapë ato i karakterizon një formë plastike e gjallë e dukshme, e cila realizohet me pjesëmarrjen e gjithë gjymtyrëve: këmbëve, duarve dhe trupit. Nga një vështrim i imtë konstatojmë se vallet e burrave, në përgjithësi, karakterizohen simbas tipeve të ndryshme nga disa elemente të veçanta plastiko-ritmike, që përbëjnë lëndën bazë mbi të cilën ngrihen. Në disa valle, veçanërisht ato që luhen me katër valltarë, këto elemente, të grupuara në motive ose figura koreografike, paraqiten me një ndërtim dhe fizionomi të përcaktuar, sidomos në përsëritjen e vazhdueshme të tyre, megjithëqë vërehen edhe në këto raste vërehen ndryshime, a variante. Përkundrazi, tek vallet «çift», spontaneiteti edhe prirja për improvizim në drejtim të varietetit të lëvizjeve sikur bije në sy më fort. Kjo shfaqet jo në të gjitha rastet dhe më fort tek valltari i parë, sidomos në kthesën e valleve kur kërcimi, siç thonë vendasit, «ndizet, merr flakë», ndërsa valltari i dytë e mban. Megjithatë, edhe pse valltari i parë improvizon, lëvizjet e tij nuk dalin nga kuadri i përgjithshëm i lëvizjeve në veçanti dhe i karakterit të këtyre valleve në përgjithësi. Këto veçori krijojnë bukuri dhe larmi në stilin e valleve të burrave; ato nuk janë të rastit dhe, padyshim, në natyrën dhe në karakterin e këtyre valleve kanë ndikuar, siç e përmendëm edhe më sipër, kushtet shoqërore, mënyra e jetesës, terreni, klima, veshja etj.

Këto valle nuk i kërcen kushdo. Pleqtë p.sh. ankohen nga të rinjtë, se këta i marrin vallet shpejt e me vull. Ne, thonë ata, kemi kërcyer «randë, randë... ngadalë, në mënyrë origjinale». Ndaj edhe të rinjtë mundohen që t'i mësojnë e t'i përvetësojnë ato me vërtetësi dhe origjinalitet. Meqenëse jo të gjithëve u bie rrada të kërcëjnë, disa mundohen që edhe me sy t'i mësojnë vallet, sidomos kur janë në dasëm.

Kur nisin të bien veglat i drejtohen atij që është më i zoti në kërcim

me këto fjalë: «apo na keen o... , ngrehu e merrja një herë o...». Ndërkaq valltari, mbasi ngrihet, u drejtohet instrumentistëve: «bini keimit të randë», ose «na merr një keim të lehtë». Gjatë valles, ose kur mbaron vallja, të pranishmit i grishin me këto fjalë: «veç me tri herë vritet nishani» ose «hej u lumshin kamët» etj. Siç shihet, gjatë kërcimit krijohet një atmosferë mjaft e gjallë dhe e gëzueshme.

Dy vegla karakteristike i shoqërojnë këto valle: surlja dhe lodra (dau-llja). Surlja luan vijën melodike, ndërsa lodra mban ritmin mbi bazën e të cilit qëndrojnë lëvizjet e valles. Këtu e ka burimin ajo pasuri e madhe ritmesh me lloj-lloj variacione si dhe ajo euritmi lëvizjesh të veshura me nuanca nga më të bukurat. Valltarët kanë të drejtë kur thonë se «ne i lumj kamët si t'bijë lodra», ose për vallen e randë: «asht e randë në të kcyeme se, edhe topuzi, edhe kranxa bijnë ma rrallë, por randë». Meloditë e valleve të grave luhen në kohën 2/4, kurse ato të burrave përgjithësisht në kohën 7/8 etj.

Rastet kur luhen vallet, janë të ndryshme. Në të kaluarën, bile deri vonë, vallet janë luajtur edhe në festa rituale si: në ditën e verës, shëngjergjin, shmrajën etj. por jo ditën e bajramit e gjatë ramazanit. Ceremoniali ku vallet kanë shpërthyer me gjithë forcën e tyre, është dasma. Mbas klimës të atdheut vallet po luhen shumë e në mënyrë masive sidomos në raste festash kombëtare, krahinore, lokale dhe në raste festivalesh folkloristike, që organizohen herë pas here. Në këto takime krahas burrave sot marrin pjesë edhe gratë, veçanërisht të rejat.

Vallja e «Lehtë» dhe vallja e «Xhafer Kabës», që do t'i paraqesim të përshkruara këtu, bëjnë pjesë në repertorin e vallëzimit të burrave të këtij rethi.

#### VALLJA E LEHTË

Origjina: kat. Kraj-Reç (rr. Dibër) Vjetërsia: valle e vjetër  
E tregoi: T. Toluli Gjinia: valle burrash  
Mbledhur: Kraj-Reç, 1964 Koha: 7/8.

#### K a r a k t e r i s t i k a t :

Vallja e «Lehtë» është një ndër kërcimet më të njohura e më të preferuara të fshatrave që bëjnë pjesë në lok. Zall-Dardhë. Kjo valle shpreh optimizëm, gjallëri, forcën burrërore, në të njëjtën kohë edhe bukurinë fizike të malësorit. Jo kushdo mund ta kërcejë këtë valle, megjithëqë është tepër kërcyese në lëvizjet, të cilat sa janë të qeta në fillim, aq marrin vrell e zjarr në fund. Gjithfarë lëvizjesh janë karakteristike për këtë valle: ngritje e këmbës së thyer përpara, hedhje nga njëra këmbë në tjetrën, me të dyja këmbët, ulje e madhe, hedhje lart në ajër drejt e me rrotullim nga e djathta 360° etj. Prandaj në ekzekutimin e saj kërkohet sa zotësi aq edhe mjeshtëri. Rol luan edhe trupi, i cili herë çohet, herë përkulet pak përpara. Të tillë forcë dhe dinamizëm shpreh edhe muzika e valles. Luhet me surle e lodër. Vallja e Lehtë bën pjesë në grupin e valleve «gift» (ose dyshe). Vallja në fillim kërcëhet nga të dy valltarët (sidomos nga i pari, i cili e tërheq vallen), ndërsa më tej ajo merr formën e një kërcimi vetjak (solo), rol të cilin e luan vetëm valltari i parë; valltari i dytë kryen funksionin e mbajtësit. Ky ndryshim ndodh

pikërisht në atë çast, kur vallja gjallërohet si nga ana muzikore ashtu dhe nga ana e kërcimit.

Vallja paraqitet me një strukturë dy pjesëshe: prej pjesës së parë (e cila përbëhet prej dy figurave koreografike dhe një tjetre, që është variacioni i figurës së dytë) dhe pjesës së dytë, ose kthesës (e cila përbëhet prej një figure kryesore dhe një tjetre, që është variacioni i saj). Figurat e valles përsëriten në mënyrë të pacaktuar; kjo varet më fort nga valltari i parë, që kalon nga njëra figurë në tjetrën duke pasur parasysh rritjen ritmike të melodisë së valles. Valltarët në valle kapen për dore; i pari me dorën e djathtë lëviz shaminë lart në ajër, ose e vendos në bel, lëvizje të cilat, të marra në përputhje me ato të këmbëve, nuk janë të përcaktuara.

Si mbaron kërcimi, valltarët mund ta përsëritin atë nga fillimi; kjo varet nga instrumentistët si dhe nga dëshira e valltarëve, të cilët në këtë rast i ndërrojnë vendet: pra vallen e tërheq edhe i dyti, kur ky e ndjen veten të aftë.

Muzika që shoqëron vallen paraqitet me një strukturë jo të rregullt përsa i takon rreshtave melodike dhe përsëritjes së motiveve. Një gjë e tillë na shfaqet edhe në vallet, ku motivet koreografike (të shprehura në figura), megjithëqë ekzekutohen në përgjithësi brenda dy masave muzikore, përsëriten në mënyrë të pacaktuar. Kjo është arsyeja që ndërmjet valles dhe muzikës nuk ka përputhje. Në përshkrimin e valles figurat koreografike janë inkuadruar dhe përsëriten në mënyrë të caktuar nga dy ose nga katër herë simbas rastit.

### *Përshkrimi i valles.*

#### Pjesa e parë Figura e parë

- Ekzekutohet në dy masa muzikore në kohën 7/8 dhe përsëritet dy herë.
- Valltarët janë të kapur për dore.
- Lëvizjet ekzekutohen me zhvendosje të vogla nga e djathta dhe anasjelltas.

#### Masa 1

- katërshe — këmba e majtë qëndron në vend, ndërsa e djathta ngrihet e thyer përpara 45°. Trupi është i orientuar përpara (pika 1). I pari e lëviz shaminë lart në ajër, ndërsa i dyti dorën e majtë e mban mbrapa në bel.
- katërshe — hap pak i thyer në të djathtën anash nga e djathta (pika 3). I pari dorën e djathtë e vendos mbrapa në bel.
- katërshe — këmba e majtë afrohet pranë së djathtës.
- tetëshe — hap i vogël me të djathtën anash nga e djathta.

#### Masa 2

- katërshe — këmba e djathtë qëndron në vend, ndërsa e majta ngrihet e thyer përpara 45°. I pari e lëviz shaminë lart në ajër.
- katërshe — hap pak i thyer me të majtën anash nga e majta (pika 7). I pari dorën e djathtë e vendos mbrapa në bel.

katërshe — këmba e djathtë afrohet pranë së majtës.  
 tetëshe — hap i vogël me të majtën anash nga e majta.

Masat 3-4: në këto dy masa përsëriten lëvizjet e mësipërme të masave 1-2.

Formula ritmike e figurës së parë.




Figura e dytë

- Ekzekutohet në dy masa muzikore në kohën 7/8 dhe përsëritet dy herë.
- Valltarët janë të kapur për dore.
- Lëvizjet ekzekutohen në rreth anash nga e djathta.

Masa 5

- katërshe — hedhje e vogël me këmbën e majtë në vend, ndërsa e djathta ngrihet e thyer përpara  $45^\circ$ . I pari e lëviz shaminë lart në ajër.
- katërshe — hap pak i thyer me të djathtën përpara (pika 3) me kthimin e trupit gjysëm djathtas. Trupi pak i përkulur përpara mbështetet mbi të. I pari dorën e djathtë e vendos mbrapa në bel.
- tetëshe — hedhje me këmbën e majtë në të njëjtin drejtim, ndërsa e djathta ngrihet mbrapa, e thyer pak përmbi tokë. Trupi drejtohet. I pari e lëviz shaminë lart në ajër. (Fig. 1)



Fig. 1

katërshe — hap pak i thyer me të djathtë në të njëjtin drejtim (edhe e majta thyhet në vend). Trupi përkulet pak përpara. I pari e vendos dorën e djathtë mbrapa në bel.

#### Masa 6

katërshe — hedhje e vogël me këmbën e djathtë në vend, me kthimin e trupit gjysëm majtas (përpara), ndërsa e majta ngrihet e thyer përpara 45°. Trupi drejtohet. I pari e lëviz shaminë lart në ajër.

katërshe — hap pak i thyer me të majtën anash nga e majta (pika 7), ndërsa e djathta ngrihet pranë saj pak e thyer. I pari dorën e djathtë e vendos mbrapa në bel.

tetëshe — hap pak i thyer me të djathtë përpara, ndërsa e majta ngrihet mbrapa e thyer, pak përmbi tokë.

katërshe — këmba e majtë ulet pak e thyer në vend. Trupi mbështetet mbi të.

Masat 7-8: në këto dy masa përsëriten lëvizjet e mësipërme të masave 5-6.

Formula ritmike e figurës së dytë.



Variacioni i figurës së dytë

— Ekzekutohet në dy masa muzikore në kohën 7/8 dhe përsëritet dy herë.

— Valltarët janë të kapur për dore.

— Lëvizjet ekzekutohen në rreth anash nga e djathta.

#### Masa 9

katërshe — hedhje me këmbën e majtë pak të thyer në vend, ndërsa e djathta ngrihet e thyer përpara 45°. I pari e lëviz shaminë lart në ajër.

gjashtëmbë-dhjetëshe — hedhje e vogël me këmbën e majtë përpara (pika 3) me

kthimin e trupit gjysëm djathtas.

tetëshe + — hap pak i thyer me të djathtë në të njëjtin drejtim. Trupi gjashtëmbë-dhjetëshe — pak i përkulur përpara mbështetet mbi të. I pari dorën e djathtë e vendos mbrapa në bel.

tetëshe — hedhje me këmbën e majtë në të njëjtin drejtim, ndërsa e djathta ngrihet mbrapa, e thyer pak përmbi tokë. Trupi drejtohet. I pari e lëviz shaminë lart në ajër. (Shih. fig. 1).

katërshe — hap pak i thyer me të djathtë me të njëjtin drejtim (edhe e majta thyhet në vend). Trupi përkulet pak përpara. I pari e vendos dorën e djathtë mbrapa në bel.

#### Masa 10

gjashtëmbë-dhjetëshe — hap kryq me të majtën mbrapa me kthimin e trupit gjysëm majtas (përpara)<sup>1</sup>. Trupi drejtohet.

<sup>1</sup> Trupi përpara kësaj lëvizjeje ishte i orientuar gjysëm djathtas (pika 2).

tetëshe — hap pak i thyer me të djathtën përpara (pika 7) me kthimin e gjashtë. Trupi gjysëm majtas. (Fig. 2).



Fig. 2

katërshe — hap pak i thyer me të majtën në të njëjtin drejtim me kthimin e trupit gjysëm djathtas (përpara), ndërsa e djathta ngrihet pranë saj pak e thyer. I pari e lëviz shaminë lart në ajër.

katërshe — hap pak i thyer me të djathtën përpara, ndërsa e majta ngrihet mbrapa e thyer pak përmbi tokë. I pari dorën e djathtë e vendos mbrapa në bel.

tetëshe — këmba e majtë ulet pak e thyer në vend. Trupi mbështetet mbi të.

Masat 11-22: në këto dy masa përsëriten lëvizjet e mësipërme të masave 9-10.

Formula ritmike e variacionit të figurës së dytë.



Pjesa e dytë (kthesa)

Figura e parë

- Ekzekutohet në një masë muzikore në kohën 7/8 dhe përsëritet katër herë.
- Valltarët janë të kapur për dore.
- Kërcen vetëm valltari i parë, ndërsa i dyti e mban. Lëvizjet ekzekutohen në rreth anash nga e djathta.

Masa 13

katërshe — hedhje me këmbën e majtë të thyer në vend, me kthimin e trupit djathtas 90°, ndërsa e djathta ngrihet e thyer për-

- para (me thembrën përbrenda). Trupi përkulet pak përpara. I pari dorën e djathtë e vendos mbrapa në bel.
- tetëshe — hedhje përnjëherë me të dyja këmbët në gjysëm ulje përpara (pika 1), me kthimin e trupit majtas  $90^\circ$  (përpara).
- tetëshe — hedhje në vend, me të dyja këmbët e thyera (pak të hapura) mbrapa. Trupi drejtohet. (Fig. 3)



Fig. 3

- tetëshe — trupi, i mbështetur mbi këmbën e djathtë të thyer, kthehet gjysëm djathtas, ndërkaq e majta (në formë gjysmë harku) del përpara pak përmbi tokë. Trupi përkulet pak përpara. (Fig. 4).




Fig. 4

katërshe — hap pak i thyer me të majtën përpara (pika 3). Trupi, i orientuar gjysëm djathtas, mbështetet mbi të.

Masat 14-15-16: në këto tri masa përsëriten lëvizjet e mësipërme të masës 13.

Formula ritmike e figurës së parë



Variacioni i figurës së parë.

- Ekzekutohet me dy masa muzikore në kohën 7/8 dhe përsëritet katër herë.
- Kërcen vetëm valltari i parë, ndërsa i dyti e mban. Lëvizjet ekzekutohen në rreth anash nga e djathta.

#### Masa 17

- katërshe — hedhje me këmbën e majtë të thyer në vend me kthimin e trupit djathtas 90°, ndërsa e djathta ngrihet e thyer përpara (me thembrën përbrenda). Trupi përkulet pak përpara. I pari dorën e djathtë e vendos mbrapa në bel.
- tetëshe — hedhje përnjëherësh me të dyja këmbët, në gjysëm ulje përpara (pika 1), me kthimin e trupit majtas (përpara) 2.
- tetëshe — hedhje në vend me të dyja këmbët të thyera (pak të hapura) mbrapa. Trupi drejtohet. (Shih fig. 3).
- tetëshe — trupi i mbështetur mbi këmbën e djathtë të thyer, kthehet gjysëm djathtas, ndërkaq e majta (në formë gjysëm harku) del përpara pak përmbi tokë. Trupi përkulet pak përpara. (Shih fig. 4).
- katërshe — hap pak i thyer me të majtën përpara (pika 3). Trupi i orientuar gjysëm djathtas mbështetet mbi të.

#### Masa 18

- tetëshe — hap i vogël pak i thyer me të djathtën me rrotullimin e trupit djathtas 90°. Valltarët shkëputen njeri prej tjetrit.
- tetëshe — hap i vogël pak i thyer me të djathtën, me rrotullimin e trupit djathtas 90°.
- katërshe — hap pak i thyer me të djathtën, me rrotullimin e trupit 90°. Trupi orientohet përpara. Valltarët kapen për dore.
- tetëshe — hedhje e vogël me të djathtën në vend, ndërsa e majta ngrihet e thyer përpara 45°. Trupi drejtohet. I pari e lëviz shaminë lart në ajër.
- katërshe — ulje e madhe në vend përnjëherësh me të dyja këmbët pak të hapura. Trupi përkulet pak përpara. I pari dorën e djathtë e vendos mbrapa në bel.

2) Trupi përpara kësaj lëvizjeje ishte i orientuar djathtas (pika 3).



The image shows a musical score for a dance piece. It consists of three systems of music, each with a treble and bass staff. The key signature is one sharp (F#), and the time signature is 2/4. The music is characterized by a rhythmic pattern of eighth and sixteenth notes, with some rests and accents. The melody is primarily in the treble staff, while the bass staff provides a steady accompaniment.

## VALLJA E XHAFER KABËS.

Origjina: kat. Murr (rr. Dibër)  
E tregoi: Q. Selimi  
Mbledhur: Zall-Dardhë, 1964

Vjetërsia: valle e re  
Gjinia: valle burrash  
Koha: 2/4

## K a r a k t e r i s t i k a t

Origjina e kësaj valleje është e vonë<sup>3</sup>. Fshatari Xhafer Kaba (nga katundi Murr), i mbështetur në përgjithësimin e lëvizjeve dhe të karakterit të valleve të burrave mundi të krijojë një valle të re në përshtatje me gjendjen e tij fizike (këmbës së djathtë nuk i lëviz artikulationi i gjurit). Pra nëpërmjet kësaj valleje shprehet dëshira e një burri çalaman për të kërcyer, megjithëqë e ka shumë të vështirë. Ndaj lëvizjet, edhe

3) Krijimi apo rigjenerimi i motiveve të valleve popullore përbën një problem me rëndësi të veçantë. Ky aspekt shfaqet në disa forma: kur një valle fillon të kërcëhet me muzikë të re, kur melodia është po ajo dhe valltarët sjellin ndryshime në lëvizjet dhe, kur krijohet në mënyrë të plotë si melodia ashtu edhe vallja. (Shih, R. Katarova *Le tradition et l'esprit novateur dans la danse populaire*, «Journal of the International Folk Music Council», Vol. XV-V/1963, p. 63). Në rastin tonë kemi të bëjmë me një krijim të plotë si të valles ashtu dhe të melodisë. Kjo na jep të drejtë të mendojmë se, tek ne, krijimtaria e valleve jo vetëm rron e gjallë, por vazhdon të pasurohet edhe me motive të reja. (Shih N. Agolli — R. Bogdani, *Kërkime koreografike në Zall-Dardhë*. «Studime filologjike», 1965, nr. 3, f. 139-153.

pse janë pak a shumë të kufizuara, e shprehin një gjendje të tillë. Por valltari megjithatë kërcen me ndihmën e një shkopi (bastuni), të cilin e mban në dorën e djathtë. Vallja në përgjithësi luhet me një ritëm. Shoqërohet me çifteli. Në valle marrin pjesë dy valltarë, nga të cilët vetëm i pari kërcen, ndërsa i dyti e mban. Përbëhet prej një pjese të vetme, që ka një figurë kryesore dhe dy të tjera që janë variacione të së parës. Lëvizjet karakteristike janë: ngritje e këmbës së djathtë përpara e shtrirë  $45^\circ$  gjysëm majtas, djathtas, hap me këmbën e djathtë të shtrirë, ndërsa e majta ngrihet prapa e shtrirë, hap kryq me të majtën mbrapa, ulje e madhe me këmbën e majtë etj.

### Përshkrimi i valles.

#### Figura e parë.

- Ekzekutohet në tetë masa muzikore në kohën 2/4 dhe përsëritet dy herë.
- Valltarët janë të kapur për krahu. Kërcen vetëm valltari i parë me ndihmën e një shkopi (bastuni), të cilin e mban në dorën e djathtë. Valltari i dytë nuk kërcen, ai luan rolin e mbajtësit.
- Lëvizjet ekzekutohen pjesërisht në vend dhe në rreth anash nga e djathta.

#### Masa 1

- katërshja — këmba e majtë thyhet pak në vend, ndërsa e djathta e e parë ngritur  $45^\circ$  shtrihet diagonal përpara majtas. Trupi i orientuar në të njëjtin drejtim, mbështetet mbi shkopin, të cilin valltari i parë e mban me dorën e djathtë të thyer në bel.
- katërshja — këmba e majtë qëndron në vend, ndërsa e djathta e ngritur e dytë zhvendoset diagonal përpara djathtas me kthimin e trupin  $90^\circ$  në të njëjtin drejtim.

#### Masa 2

- katërshja — këmba e majtë qëndron në vend, ndërsa e djathta e ngritur e parë zhvendoset diagonal përpara majtas, me kthimin e trupit  $90^\circ$  në të njëjtin drejtim.
- katërshja — këmba e majtë qëndron në vend, ndërsa e djathta e ngritur e dytë zhvendoset diagonal përpara djathtas me kthimin e trupit  $90^\circ$  në të njëjtin drejtim.

Masat 3-4 : në këto dy masa përsëriten lëvizjet e mësipërme të masave 1-2.

#### Masa 5

- katërshja — hap me të djathtën (me gjithë shuallin) anash nga e djathta e parë (pika 3). Trupi i orientuar përpara mbështetet mbi të. Vall-

katërshja — tari mbështetet me dorën e djathtë mbi shkopin.<sup>4</sup> (Fig. 5).  
e dytë — hap kryq pak i thyer me të majtën mbrapa. Trupi mbështetet mbi të (e djathta qëndron e shtrirë përpara).

## Masa 6

katërshja — hap me të djathtën (me gjithë shuallin) anash nga e djathta  
e parë (pika 3). Trupi mbështetet mbi të. Valltari mbështetet me dorën e djathtë mbi shkopin.<sup>5</sup>



Fig. 5

katërshja — hap kryq pak i thyer me të majtën mbrapa. Trupi mbështetet mbi të (e djathta qëndron e shtrirë përpara)

Masat 7-8 : në këto dy masa përsëriten lëvizjet e mësipërme të masave 5-6.


Masat 9-16 : në këto tetë masa përsëriten lëvizjet e mësipërme të masave 1-8.

4) Përnjëherë me hapin nga e djathta valltari e lëviz edhe shkopin në të njëjtin drejtim.

5) Shkopi bën të njëjtën lëvizje.

Masat 7-8 : në këto dy masa përsëriten lëvizjet e mësipërme të masa

Formula ritmike e figurës së parë.



Variacioni i parë i figurës së parë

- Ekzekutohet në tetë masa muzikore në kohën 2/4 dhe përsëritet dy herë.
- Lëvizjet ekzekutohen pjesërisht në vend dhe në rreth anash nga e djathta.

#### Masa 17

katërshja — hedhje e vogël me këmbën e majtë pak të thyer në vend,  
e parë ndërsa e djathta e ngritur  $45^\circ$  shtrihet diagonal përpara majtas. Trupi i orientuar në të njëjtin drejtim, mbështetet mbi shkopin të cilin valltari i parë e mban me dorën e djathtë të thyer në bel.

katërshja — hedhje e vogël me këmbën e majtë pak të thyer në vend,  
e dytë ndërsa e djathta e ngritur zhvendoset diagonal përpara djathtas, me kthimin e trupit  $90^\circ$  në të njëjtin drejtim.

#### Masa 18

katërshja — hedhje e vogël me këmbën e majtë pak të thyer në vend,  
e parë ndërsa e djathta e ngritur zhvendoset diagonal përpara majtas, me kthimin e trupit  $90^\circ$  në të njëjtin drejtim.

katërshja — hedhje e vogël me këmbën e majtë pak të thyer në vend,  
e dytë ndërsa e djathta e ngritur zhvendoset diagonal përpara djathtas me kthimin e trupit  $90^\circ$  në të njëjtin drejtim.

Masat 19-20 : në këto dy masa përsëriten lëvizjet e mësipërme të masave 17-18.

#### Masa 21

katërshja — hap me të djathtë në majë të gishtave përpara (pika 3),  
e parë ndërsa e majta ngrihet prapa e shtrirë  $45^\circ$ . Trupi është i orientuar gjysëm djathtas. Valltari mbështetet me dorën e djathtë mbi shkopin.

katërshja — hap kryq mbrapa me të majtën të thyer. Trupi mbështetet  
e dytë mbi të (e djathta qëndron e shtrirë përpara).

#### Masa 22

katërshja — hap me të djathtë në majë të gishtave në të njëjtin drejtim,  
e parë ndërsa e majta ngrihet mbrapa e shtrirë  $45^\circ$ . Valltari mbështetet me dorën e djathtë mbi shkopin.

katërshja — hap kryq mbrapa me të majtën të thyer. Trupi mbështetet  
e dytë mbi të (e djathta qëndron e shtrirë përpara).

Masat 23-24 : në këto dy masa përsëriten lëvizjet e mësipërme të masave 21-22.

Masat 25-32 : në këto tetë masa përsëriten lëvizjet e mësipërme të masave 17-24.

Formula ritmike e variacionit të parë të figurës së parë.



Variacioni i dytë i figurës së parë.

- Ekzekutohet në tetë masa menjëherë në kohën 2/4 dhe përsëritet dy herë.
- Lëvizjet ekzekutohen pjesërisht në vend edhe në rreth anash nga e djathta.

Masa 33

- katërshja e parë — ulje e madhe me këmbën e majtë në vend, ndërsa e djathta e ngritur shtrihet diagonal përpara majtas me kthimin e trupit majtas  $90^\circ$  (pika 8)<sup>6</sup>. Valltari mbështetet me dorën e djathtë mbi shkopin (i cili qëndron vertikal).
- katërshja e dytë — në atë pozicion këmba e djathtë e ngritur zhvendoset diagonal përpara djathtas me kthimin e trupit  $90^\circ$  në të njëjtin drejtim. (Fig. 6).



Fig. 6

6) Përpara kësaj lëvizjeje trupi është i orientuar gjysëm djathtas (pika 2).

## Masa 34

katërshja — në atë pozicion këmba e djathtë e ngritur zhvendoset diagonal përpara majtas, me kthimin e trupit  $90^\circ$  në të njëjtin drejtim.

katërshja — në atë pozicion këmba e djathtë e ngritur zhvendoset diagonal përpara djathtas me kthimin e trupit  $90^\circ$  në të njëjtin drejtim.

Masat 35-36 : në këto dy masa përsëriten lëvizjet e mësipërme të masave 33-34.

## Masa 37:

katërshja — hap me të djathtën në majë të gishtave përpara (pikë 3), e parë ndërsa e majta ngrihet mbrapa e shtrirë me  $45^\circ$ . Trupi është i orientuar gjysëm djathtas. Valltari mbështetet me dorën e djathtë mbi shkopin.

katërshja — hap kryq me të majtën mbrapa të thyer. Trupi mbështetet e dytë mbi të (e djathta qëndron e shtrirë përpara).

## Masa 38

katërshja — hap me të djathtën në majë të gishtave në të njëjtin drejtim, e parë ndërsa e majta ngrihet mbrapa e shtrirë  $45^\circ$ . Valltari mbështetet me dorën e djathtë mbi shkopin.

katërshja — hap kryq me të majtën mbrapa të thyer. Trupi mbështetet e dytë mbi të (ndërsa e djathta qëndron e thyer përpara).

Masat 39-40 : në këto dy masa përsëriten lëvizjet e mësipërme të masave 37-38.

Masat 41-48 : në këto tetë masa përsëriten lëvizjet e mësipërme të masave 33-40.

Formula ritmike e variacionit të dytë të figurës së parë.



Andante  $\text{♩} = 80$  accelerando poco a poco fino a  $\text{♩} = 94$

The image displays a musical score for a piece titled "Dy valle dibrane". The score is written on 14 staves of music. The tempo is marked "Andante" with a metronome marking of  $\text{♩} = 80$ , and it includes the instruction "accelerando poco a poco fino a  $\text{♩} = 94$ ". The music is in a 2/4 time signature and features a melodic line with various rhythmic patterns, including eighth and sixteenth notes, and rests. The notation includes dynamic markings such as *mf* and *f*, and articulation marks like accents and slurs. The piece concludes with a final cadence on the 14th staff.

## R é s u m é

## DEUX DANSES POPULAIRES DIBRANES

L'auteur brosse tout d'abord un panorama général sur les danses populaires jouées dans la région de la Dibra (Peshkopi). Les données obtenues jusqu'à maintenant permettent de constater que la région de la Dibra non seulement est riche en danses, mais qu'elle offre un grand intérêt aussi pour ce qui est de l'originalité, le style en général et les moyens expressifs plastiques et rythmiques très riches, très variés.

Du répertoire de danses on distingue deux types: les danses des femmes et les danses des hommes. Ces danses se font distinguer entre elles. Ces distinctions, qui se manifestent dans le contenu, le style, le caractère ainsi que dans les éléments plastiques, rythmiques, sont conditionnées, sans nul doute, des facteurs historico-sociaux, du milieu géographique, du climat, de l'habillement, etc. Et, en cela on doit tenir présents aussi les traditions formées au cours des âges.

Les danses des femmes sont simples comme structure et comme contenu plastique et rythmique. Cela est à rattacher, avant tout, à la condition déplorable de la femme dans le passé, au pressurage des coutumes sévères, à la religion. Elle ne jouissait point de droits égaux à l'homme.

Les danses des femmes, jusque récemment encore, n'étaient accompagnées que par des chants de caractère lyrique. On a commencé à mettre en usage la çifteli, et, même, ces derniers temps, aussi la surle et le tambour, etc. Aux danses prennent part deux, trois, ou quatre individus, détachés l'un de l'autre. Dans la main droite ils tiennent le mouchoir, ou même aussi des deux mains. Les pas sont déplacés dans toutes les directions: un pas long à droite, deux petits pas à gauche par le pied gauche et le droit. Ce mouvement appartient à la danse accompagnée par la çifteli.

Les danses des hommes sont plus riches aussi bien comme contenu que comme structure chorégraphiques. Les habitants de la Dibra passent vraiment pour des maîtres de la danse. Mais, la danse n'est pas considérée seulement comme un élément d'agrément, mais, avant tout, comme un moyen artistique au moyen duquel ils extériorisent, quoique d'une façon symbolique, le caractère viril, vaillant et fort du Dibrane. Un esprit épique empreint ces danses. Leur force expressive a le pouvoir de vous attirer, de vous captiver.

Un trait distinctif sont les danses «en couples» ou «doubles», à construction d'une ou de deux parties. Ces danses sont jouées par deux danseurs, dont le premier danse (le soliste), tandis que le deuxième «tient», c'est-à-dire accompagne, lentement le premier danseur dans l'exécution des mouvements. Dans ces danses, la spontanéité ou la tendance d'improvisation est trop grande. Néanmoins, ces mouvements ne débordent pas le cadre général des mouvements et du caractère de ces danses.

Les danses jouées par quatre individus, ou bien un nombre supérieur, sont plus encadrées pour ce qui est des motifs chorégraphiques et leurs répétitions.

*Les danses des hommes sont accompagné par la surle et le tambour. Lorsqu'elles sont exécutées à l'intérieur des habitations, alors on emploie habituellement la çifteli.*

*Actuellement les danses sont joués pendant les noces, les fêtes nationales, locales et aux festivals folkloriques. A ces rencontres, à côté des hommes participent aussi les femmes, notamment les jeunes. Durant les festivités religieuses, les danses n'ont pas connu d'exécution.*

*Dans l'article sont présentées en transcription deux des danses des hommes, jouées dans le district de la Dibra: la Vallja e lehtë (Danse légère) et la Vallja e Xhafer Kabës (La danse de Xhafer Kaba).*

